V E N D I M
Nr. 609, datë 4.12.2002

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË, KORPORATËS NDËRKOMBËTARE FINANCIARE DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN "SHËRBIMI KËSHILLIMOR PËR INVESTIMET E HUAJA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Korporatës Ndërkombëtare Financiare dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin "Shërbimi këshillimor për investimet e huaja".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

Memorandum i mirëkuptimit, datë _____ 2002 midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (që në material do t'i referohemi me emrin "Qeveria"), Korportatës Ndërkombëtare të Financave (Korporata), dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), (Korporatës dhe IBRD-s do t'i referohemi me emrin "organizatat") për administrimin e disa fondeve nga organizatat të cilat Qeveria do t'i vërë në dispozicion të Shërbimit Këshillimor për Investimet e Huaja (FIAS) në formën e një granti, për bashkëfinancimin e projektit FIAS. Me kërkesën e Qeverisë, projekti FIAS përbëhet prej: (i) një studimi mbi pengesat administrative (për investimet e huaja në Shqipëri); dhe (ii) për të dhënë rekomandime për përmirësimin e programeve politike dhe institucioneve, me qëllim që të tërhiqen investime të huaja në Shqipëri ("Projekti").

Organizatat kanë krijuar FIAS si një program pjesërisht i financuar nga donatorët për t'i këshilluar qeveritë e vendeve në zhvillim se si të përmirësojnë politikat, programet dhe institucionet për të tërhequr investitorët e huaj, duke i këshilluar për ligjet, politikat, stimujt, institucionet dhe strategjitë.

FIAS nuk është ligjërisht e pavarur, pasi organizatat kanë përgjegjësi të plotë ligjore dhe administrative për aktivitetet e FIAS.

Organizatat mund të pranojnë kontribute vullnetare nëse ato janë në përputhje me politikat, synimet dhe aktivitetet e organizatave. Organizatat pranojnë të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e Projektit.

Si rrjedhim, Palët bien dakord si më poshtë:

1. Kosto e përgjithshme e Projektit llogaritet në 175.530 USD, e cila do të bashkëfinancohet nga Qeveria, FIAS dhe Fondacioni SOROS.

2. Qeveria dhe FIAS do të kontribuojnë si më poshtë:

a) Qeveria do të kontribuojë me shumën 58.000 USD (pesëdhjetë e tetë mijë dollarë amerikanë) ("Grant") në mbështetje të Projektit;

b) FIAS do të kontribuojë në shumën 90.100 USD (nëntëdhjetë mijë e njëqind dollarë amerikanë) në mbështetje të Projektit.

3. Qeveria dhe FIAS janë në dijeni të kontributit të Fondacionit SOROS në shumën 27.430 USD (njëzet e shtatë mijë e katërqind e tridhjetë dollarë amerikanë) në mbështetje të pjesës në Projekt që ka të bëjë me studimin/vrojtimin mbi kompanitë private, sipas një marrëveshjeje me kontratë të veçantë midis fondacionit SOROS dhe firmës së zgjedhur për mbikëqyrje.

4. Projekti do të zbatohet duke filluar nga data 25 mars 2002, me shtrirje 8-mujore.

5. Organizatat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar zbatimin e plotë të Projektit në kohë.

6. Organizatat janë dakord dhe do të përgjigjen për sigurimin e shërbimeve të parashikuara në propozimin e Projektit bashkëngjitur në këtë memorandum.

7. Trust Fondi ekzistues FIAS u krijua për financimin e aktiviteteve të FIAS. Për zbatimin e Projektit në fjalë ky trust fond mund të shërbejë si një mjet i përshtatshëm për përfitimin dhe disbursimin e Grantit.

8. Fondet Grant do të administrohen si pjesë e Trust Fund FIAS, për të cilin kontribuojnë edhe donatorë të tjerë. Një numër i veçantë i Projektit do të ruhet për Grantin. Për arsye të kontabilitetit, fondet Grant të Projektit do të trajtohen si një kontribut shtesë i veçantë për Trust Fund FIAS dhe do të zbatohen kushtet ekzistuese për përdorimin e lekëve nga Trust Fund Fias.

9. Qeveria do ta depozitojë kontributin në dollarë amerikanë në llogarinë e mëposhtme ("llogaria") sipas udhëzimeve të mëposhtme për pagesën:

Emri i Bankës:HSBC Bank USA
Adresa:140 Brodway Street
NewYork, New York, 10005
ABA No.021001088
SWIFT ADDRESS: MRMDUS33
Emri i llogarisë:International Bank for Reconstruction and Development
Numri i llogarisë: Llogaria "T" No.000125199

Për kryerjen e pagesave Qeveria do të udhëzojë HSBC Bank SHBA, New York, Drejtorinë e Jashtme për të këshilluar departamentin e veprimeve të thesarit të IBRD-s nëpërmjet SWIFT MT 910 për shumën e marrë, datën e depozitimit dhe që depozita është marrë për FIAS TF 020240 si kontribut për një projekt të veçantë për projektin FIAS Nr. 1801022. Qeveria do t'i dërgojë FIAS me faks një kopje të udhëzimeve për depozitimin në numrin e faksit (202-522-3261), për dijeni Z.Michael U.Klein, Drejtor i Përgjithshëm, FIAS.

10. Grant do të depozitohet në dy këste si më poshtë:

(i) me hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi, Qeveria do të depozitojë këstin e parë në shumën 29.000 USD (njëzet e nëntë mijë dollarë amerikanë); dhe

(ii) kësti i dytë dhe i fundit prej 29.000 USD (njëzet e nëntë mijë dollarë amerikanë) do të depozitohet në llogarinë pas marrjes nga FIAS të një faturë që përcakton përdorimin e Grantit për shpenzimet që lidhen me Projektin.

11. Faturat që përmenden në paragrafin 10 (ii) do t'i dërgohen Ministrisë së Ekonomisë së Qeverisë së Republikës të Shqipërisë.

12. FIAS do t'i dërgojë Qeverisë një kopje të raportit përfundimtar për Projektin me përfundimin e tij. Raporti përfundimtar duhet të jetë në përputhje me termat e referencës siç parashikohet në aneksin (2) të këtij Memorandumi.

13. Qeveria dhe Organizatat do të konsultohen herë pas here me kërkesën e secilës Palë për çështjet që dalin nga ky Memorandum.

14. Nëse Organizatat apo Qeveria mendojnë që ky Memorandum nuk mund të zbatohet në mënyrë efektive, Memorandumi do të ndërpritet tridhjetë (30) ditë pas marrjes së njoftimit me shkrim nga secila Palë të vendimit për ndërprerjen e tij nga Pala tjetër.

15. Me ndërprerjen e këtij Memorandumi, siç përshkruhet në paragrafin 13 më sipër, pjesa e mbetur e kontributit që nuk është përdorur nga Organizatat sipas këtij Memorandumi do t'i kthehet Qeverisë, nëse Palët nuk bien dakord ndryshe.

16. Ky Memorandum do të amendohet vetëm me marrëveshje me shkrim nga Organizata dhe Qeveria.

17 Ky Memorandum do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme të miratimit të secilës Palë.

18. Organizatat do të tregojnë të njëjtin kujdes dhe zell në kryerjen e funksioneve të tyre sipas këtij Memorandumi siç tregojnë në administrimin dhe trajtimin e çështjeve të tyre.

19. Zyrat përgjegjëse për koordinimin e të gjitha çështjeve që lidhen me Memorandumin janë:

Për Qeverinë Për Organizatën

Departamenti i Promovimit të Biznesit Ministria e Ekonomisë	FIAS 1818 H Street NW Washington, DC

Ky Memorandum është përgatitur në dy kopje.

Për Qeverinë Përfaqësuesi i autorizuar	Për Korparatën Financiare Ndërkombëtare dhe Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Arben Malaj	Michael U.Klein